

# MANUAL

## Gazetaria qytetare me smartphone



# TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrja.....4

**Moduli 1.** Skenari i një reportazhi.....8

1.1 Çfarë është reportazh?.....8

1.2 Skripti i një reportazhi.....9

1.2.1 Hapat për shkrimin e një skenari reportazhi.....9

1.2.2 Shkrimi i skenarit.....9

1.3 Përcaktimi i titujve.....12

**Moduli 2.** Fotografitë për reportazh.....14

2.1 Rregullat për fotografitë e reportazhit.....14

2.2 Aplikacionet për të realizuar fotografi.....16

**Moduli 3.** Videot për reportazh.....20

3.1 Rregullat për realizimin e videove në reportazh.....20

3.2 Editimi i videove.....22

**Moduli 4.** Publikimi i reportazhit.....26

4.1 Format e publikimit.....26

4.2 Platformat online.....27

Manuali u realizua nga organizata “Center for Bridging Communities” në kuadër të projektit: “Forumi i Reporterëve të Rinj për Diversitetin”.

@Center for Bridging Communities, Dhjetor 2022

Ky manual është realizuar në kuadër të programit Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022 me mbështetjen financiare të Kongresit Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e organizatorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Kongresit Rinor Kombëtar apo Bashkisë Tiranë.



KONGRESI  
RINOR  
KOMBËTAR



BASHKIA  
TIRANË









## HYRJA

Ky është një udhëzues gjithëpërfshirës i krijuar nga Center For Bridging Communities në kuadër të projektit: “Forumi i Reporterëve të Rinj për Diversitetin” që synon fuqizimin e të rinjve përmes njohurive praktike mbi përdorimin e mjeteve e aplikacioneve si dhe udhëzimet mbi hapat e krijimit të një reportazhi.

Teksa teknologjitë vijojnë të përparojnë dhe të bëhen lehtësisht të arritshme, telefonat shërbejnë si mjet kryesor në raportimet e lajmeve për çështje që kanë rëndësi për qytetarët dhe për komunitetet e tyre.

Ky manual ka si qëllim fuqizimin e të rinjve përmes krijimit të historive digjitale duke përdorur telefonat inteligjentë (Smpartphonat). Ai është i ndarë në katër module për të qënë sa më i kuptueshëm dhe për të theksuar elementët kryesorë për krijimin e një reportazhi.



... **Moduli** ...






## 1.2 SKENARI I NJË REPORTAZHI

### 1.1 ÇFARË ËSHTË NJË REPORTAZH?

Reportazhi është përshkrim narrativ i ngjarjes dhe përjetim subjektiv i asaj ngjarjeje. Për të njëjtën temë mund të shkruhet një raport dhe një reportazh, por për dallim nga raporti një reportazh ka përjetim subjektiv të temës dhe përshkrim letrar. Ndonëse reportazhi varet thellësisht nga detajet e ngjarjeve dhe eksperiencat e personave që rrëfejnë historitë e tyre, përshkrimi i detajeve bëhet në mënyrë objektive.

Reportazhi përfshin aspekte të gazetarisë, të tilla si rrëfime të dëshmitarëve okularë të ngjarjeve të jetës reale, fakte, kërkime, sfonde historike, fotogazetari, burime, citate dhe intervista (Study Smarter).

Duke komentuar përvojat e subjekteve që janë pjesë e reportazhit, gazetarët synojnë të japin një tablo më të gjerë të “çështjeve aktuale rreth kulturës, politikës dhe shoqërisë”. Reportazhet mund të realizohen edhe mbi jetën e një personi të njohur publik, ku përpos intervistave, gjatë narracionit mund të paraqiten edhe peizazhe.



### 1.2.1 Hapat për shkrimin e një skenari reportazhi

Zgjidhni një temë: Përcaktoni temën dhe çështjen/t që dëshironi të trajtoni në reportazhin tuaj. Tema mund të jetë mbi një ngjarje, një vend ose një person, që është me interes për audiencën tuaj. Edhe pse nuk ka ndonjë rregull për tematikën e reportazhit, një parim vlen gjithmonë: tema e panjohur shfaq më tepër interes për audiencën e zakonshme.

Personazhet: Personazhet duhet të jenë gjithmonë realë, të tipizuar mirë e në përputhje me veprimet e tyre.

Hulumtoni: Mblidhni sa më shumë informacion që të mundeni për temën. Kjo përfshin intervistat me njerëz që kanë njohuri të mira rreth temës si dhe rishikimin e dokumenteve ose burimeve të tjera të informacionit.

*Kur krijoni skriptin tuaj, disa pyetje që duhet të bëni janë:*

- Cili është qëllimi i reportazhit?
- A ka në fokus një problematikë të caktuar?
- Cilët janë personazhet?
- Çfarë elemente vizuale duhen vendosur për të plotësuar zërin e personazheve?

### 1.2.2 Shkrimi i skenarit:

Bëni një skicë paraprake: Krijoni një skicë për skenarin tuaj të reportazhit. Kjo do t'ju ndihmojë të organizoni mendimet tuaja dhe të siguroheni që të mbulonit të gjitha aspektet e rëndësishme të temës që keni zgjedhur.

Bazuar në skicën tuaj, filloni me një hyrje tërheqëse për audiencën. Përdorni gjuhë përshkuese për të prezantuar temën që në fillim dhe për ta bërë dëgjuesin të ndjehet si pjesë e historisë.

Skripti do t'ju vijë në ndihmë sidomos në rastin kur reportazhin nuk po e krijoni vetëm ju por është një punë në grup, duke lehtësuar koordinimin e siguruar që informacioni të jetë i shpërndarë tek çdo anëtar i grupit.

Kur shkruani skenarin, sigurohuni që fjalitë tuaja të jenë koncize; shkruani në kohën e tashme; zgjidhni tonin e duhur të zërit; lexoni me zë të lartë; riformuloni dhe përdorni fjali të shkurtra.

*Pasi të identifikoni një skicë për trajtimin e temës, përgjigjuni këtyre pyetjeve:*

- Çfarë ka ndodhur?
- Pse ka ndodhur?
- Kush është i përfshirë?
- Ku & kur ka ndodhur?

## REDAKTONI DHE RISHIKONI SKENARIN

Sapo të keni përfunduar shkrimin e skenarit të reportazhit, kthehuni edhe njëherë në fillim dhe redaktojeni për më shumë qartësi, përmbledhje dhe rrjedhshmëri. Hiqni çdo detaj të panevojshëm ose informacione të përsëritura dhe sigurohuni që teksti juaj është i lehtë për t'u kuptuar dhe gjithashtu tërheqës për audiencën.

Çdo herë që informacioni në historinë tuaj vjen nga një burim dhe jo nga vëzhgimet, duhet t'i atribuohet (citohej). Një rregull i mirë është që të atribuohet një herë në paragraf nëse tregoni historinë kryesisht nëpërmjet komenteve nga një intervistë ose dëshmitarë okularë për një ngjarje.

### AUDIENCA:


- Kush dëshironi të shohë reportazhin tuaj?
- Cila është grupmosha e tyre?
- A janë ata një grup i caktuar njerëzish që kanë të njëjtin interes mbi temën?

### NDIKIMI:

- A është tema e rëndësishme për audiencën tuaj të synuar?
- A është interesante për audiencën tuaj?
- Çfarë mund të ndodhë si rezultat i historisë tuaj?

### KOHA:

- Çfarë ndryshimi po sillni për temën që trajtoni?
- A është informacioni i përditësuar dhe autentik?
- A ka një ngjarje ose një përkujtim të një ngjarjeje (shembull: festë ose Ditë Botërore në lidhje me temën) kur mund të publikohet reportazhi juaj për të rritur impaktin?




## Në vëmendje për reportazhin



Hulumtoni sa më shumë mbi tematikën që është në fokus. Rilexoni skenarin tuaj për të gjetur gabime faktike ose informacione të rëndësishme që mund të mos jenë përfshirë.

Mos hezitoni të bëni pyetje të vështira gjatë një interviste. Personazhet e duhura mund t'ju ofrojnë njohuri dhe informacione të rëndësishme për temën që po shkruani. Gjithmonë verifikoni nëse informacioni është i vërtetë duke e verifikuar me burime të tjera. Mos harroni audiencën dhe mesazhin kryesor të reportazhit tuaj.



## 1.3 PËRCAKTIMI I TITULLVE



Pasi keni hulumtuar mbi temën, keni krijuar skriptin dhe jeni drejt përfundimit të punës suaj, këtu vjen një nga pjesët më të rëndësishme të procesit: të shkruarit të një titulli.

Disa këshilla për shkrimin e titullit:




**Të jeni të saktë:** Një titull duhet të tërheqë audiencën dhe të jetë objektiv. Vendosni një titull të shkurtër: Një shembull mund të jetë "Planeti Plastik".

**Të jeni të drejtpërdrejtë:** Një titull i drejtpërdrejtë, tërheq më shumë vëmendjen e audiencës.

**Shkruani në kohën e tashme:** Edhe nëse shumica e informacioneve përçaruar tek marrësit shkruhen në kohën e kaluar, titujt duhet të jenë pothuajse gjithmonë në kohën e tashme.

... ..  
**Moduli** ... ..

**2**






Fotografitë janë një përbërës i rëndësishëm i reportazhit, pasi mund të ndihmojnë në sjelljen në jetë të subjektit dhe në paraqitjen vizuale të historisë për publikun.

Sipas Daniel Oneil: “Fotogazetaria tregon një histori jo me mijëra fjalë, por në një seri fotosh. Ashtu si një lajm i shkruar paraqet një panoramë të plotë duke ofruar një pasqyrë, një tezë, tema dhe këndvështrime të ndryshme, fotoreportazhi e arrin të njëjtin objektiv fotografikisht” (Oneil, D., përditësuar në 22 Qershor 2023).



## 2.1 Rregullat për fotografitë e reportazhit

1. Rregulli i të tretave: Ndani ekranin tuaj në 9 seksione të barabarta. Subjekti mund të jetë në cilëndo prej pikave të kryqëzuara siç është shfaqur më poshtë:



2. Bëni foto të shumta në të njëjtin kënd, që në fund të zgjidhni më të mirën prej tyre.

3. Fokusojeni mirë kamerën për të shmangur imazhe të turbullta.

4. Shmangni sa më shumë “zoom”, pra zmadhimin e fotos, pasi mund të ulë cilësinë e saj.
5. Mos aplikoni filtra që ndryshojnë pamjen (si ato të Snapchat)
6. Rregulloni ndriçimin
7. Rregulloni ngjyrat
8. Bëni “crop”, pra hiqni hapësirën boshe të panevojshme



### Këshilla për përdorimin e fotove në reportazh:

*Zgjidhni fotografi me cilësi të lartë:*

Përdorni fotografi me cilësi të lartë dhe rezolucion të lartë, që janë të qarta. Sigurohuni që fotot të kenë lidhje me temën dhe të ndihmojnë në tregimin e ngjarjes.

*Përdorni kombinime të fotove:*

Përfshini kombinime ose montazhe të fotove, që tregojnë aspekte të ndryshme të temës. Kjo mund të përfshijë fotografi nga afër për detaje të rëndësishme, fotografi me kënd të gjerë për një panoramë të qartë të ngjarjes.

*Vendosni diçitura:*

Vendosni diçitura për fotot tuaja, të cilat shpjegojnë kontekstin e ngjarjes.




## 2.2 APLIKACIONET PËR TË REALIZUAR FOTOGRAFI

Ka disa aplikacione që mund të përdorni për të realizuar fotografi përveç kamerës së telefonit tuaj:

Këto aplikacione kanë filtra të paracaktuar, të cilët mund të jenë të dobishëm për fotoreportazhin me Smartphone. Ato ofrojnë gjithashtu mjete të editimit, si ndryshimi i shkëlqimit, intensiteti i ngjyrës në një foto, prerja etj.

I njohur për filtrat e tij të paracaktuar, aplikacioni **VSCO** gjithashtu mund të bëjë fotografi dhe më pas t'i modifikojë ato.



**SNAPSEED** është i lehtë për t'u përdorur. Bërja e fotografive është e thjeshtë pasi ju duhet vetëm të prekni ikonën e madhe "plus" (+) në ekran. Ka edhe filtra të paracaktuar në Snapseed që mund t'i përdorni për të rregulluar fotot tuaja.




Programi **ADOBE LIGHTROOM** ju jep kontroll të plotë se si dëshironi të editoni fotot tuaja si dhe te zgjidhni ngjyrat që dëshironi të modifikoni.



... Moduli ...

3





Videot janë relativisht më të shkurtra dhe janë më tërheqëse për audiencën se raportet e shkruara: “Kështu që audiencia mund të kuptojë lehtësisht idenë e përmbajtjes suaj. Dhe në fund, sigurohuni që reportazhi të vizualizohet mirë, me audio, etj., të jetë sa më i qartë dhe efektiv” (Wilson, D., publikuar në 20 Prill 2023).

Video reportazhet sjellin për publikun ngjarje që ndodhin në terren apo në mjedise të brendshme: “Një video reportazh është kur dikush është në skenën e një veprimi dhe kap në video çfarë ndodh dhe e sjell për të tjerë që nuk janë të pranishëm” (Citizen Journalism video reportage, “How to make a video reportage with your smartphone”, fq. 3).

### 3.1. RREGULLAT PËR REALIZIMIN E VIDEOVE NË REPORTAZH

Për realizimin e videove për reportazh ka disa rregulla që duhet të jenë në vëmendje.

**Shkruani planin e filmimeve:** Para se të filloni filmimet, skiconi një plan për videot që dëshironi të përfshini në reportazh. Kjo do t’ju ndihmojë të kapni të gjitha momentet e rëndësishme dhe të siguroheni që keni mjaftueshëm material për të treguar historinë. Realizoni një kombinim të këndeve të filmimit: Ashtu si në fotografi, përdorni një kombinim të këndeve të filmimit, për të treguar aspekte të ndryshme të historisë. Kjo mund të përfshijë filmime nga afër, me kënd të gjerë dhe objekte në lëvizje që ndihmojnë në transmetimin e ndjesisë dhe atmosferës së historisë.

**Përdorni audio natyrale:** Përdorni audio natyrale për të treguar historinë në një mënyrë që audiencia të përfshihet sa më shumë. Kushtojini rëndësi regjistrimit cilësor të audios për njerëz që flasin, eliminimit të zhurmave në sfond, ose tingujve të tjerë që lidhin skenat e ndryshme.

**Redaktoni dhe rishikoni filmimet:** Pasi të keni përfunduar filmimet, editoni videot, për t’u siguruar që të kenë cilësi të lartë dhe të tregojnë historinë në një mënyrë tërheqëse. Disa nga udhëzimet e mësipërme të fotografive vlejné dhe për vidiot siç janë rregulli i të tretave, ndriçimi, fokusimi, etj.

*Elementet në veçanti janë:*

#### Orientimi


Orientimi me të cilën mund të xhironi një video është ose peizazh ose portret. Zgjidhni një prej tyre dhe mos kaloni nga një kënd peizazh në portret ose e anasjellta pasi rezultati nuk do jetë i duhuri për shikuesin. “Gjithmonë duhet të filmoni horizontalisht” (Learn the Life, 2019:8).

#### Audio

Audioja është një pjesë shumë e rëndësishme e një videoje. Sigurohuni që audioja e videos dhe zëri të jenë të qartë. Në pamundësi të një mikrofoni për të kapur qartë zërin e personit, gjëja më e mirë që mund të bëni është të gjeni një vend të qetë.

#### Pamjet

Ekzistojnë dy lloje filmimesh: videot kryesore që tregojnë subjektin duke folur dhe pamjet që mund të shtohen për të mbështetur atë për të cilën po flet subjekti. Përdor një tripod për të siguruar pamje të qëndrueshme:



## 3.2. SI EDITOHEN VIDEOT

Pasi xhirimi juaj të ketë përfunduar, mund të filloni të editoni. Ja disa aplikacione për editimin e videove që mund të përdorni:

**Quik** është aplikacioni i krijuar për videot e realizuara në GoPro, por rezulton të jetë i dobishëm edhe për videot të realizuara në telefon. Quik është për fillestarët pasi ka modele që ju lejojnë thjesht të shtoni një video të re dhe materiali juaj do të përfundojë, por meqenëse ka vetëm modele, mund të bëni redaktim manual të videos si vendosja e titrave.

**iMovie** është aplikacioni i redaktimit të videove nga iPhone. Ndërsa i projektuar për fillestarët, iMovie provon të jetë një aplikacion i dobishëm për redaktimin e videove që mund të japë një rezultat të mirë. Kjo ju lejon të përfshini disa klipe dhe madje edhe muzikë në sfond në të njëjtën kohë. Ju gjithashtu mund të mbivendosni tekstin dhe titrat.

**KineMaster**, i ngjashëm me iMovie ofron të njëjtat funksione të redaktuesit të videove të nivelit profesional. Ai është aplikacioni më i mirë i redaktuesit të videove për Android, por e vetmja pengesë është se ka “watermark” kur përdoret versioni pa pagesë.



Quik



iMovie



KineMaster

Disa programe të tjera që mund të përdoren falas për editimin e videove janë:


**Lightworks** (suport për multi-cam, vegla të shumëllojeshme),

**Shotcut** (suport për 4K, editime në timeline),


**OpenShot** (open source, tranzicione, prerje, rotullim, shkurtim),

**Avidemux** (menu e thjeshtë me mjete bazike, ideale për fillestarët).

... Moduli ...



4






## 4.1 FORMAT E PUBLIKIMIT

Reportazhet mund të publikohen në mediat tradicionale dhe mediat sociale.

- *Publikimet në mediat tradicionale:* Nëse e dërgoni reportazhin për t'u publikuar në televizione, mund t'ju kërkohet një përmbledhje e shkurtër e reportazhit tuaj.
- *Publikimet në mediat sociale:* Mediat sociale mund të jenë mjete të fuqishme për promovimin e reportazhit dhe gjithashtu të angazhimit me audiencën tuaj. Konsideroni krijimin e një llogarie të dedikuar në mediat sociale për publikimin e reportazhit për të ndarë linkun dhe përdorni hashtag-e për të ndërvepruar me ndjekësit tuaj.

Pavarësisht se ku vendosni ta publikoni reportazhin tuaj, duhet të jeni të gatshëm për reagimet dhe kritikën që mund të vijnë. Konsiderojini kritikën konstruktive për të përmirësuar punën tuaj në të ardhmen dhe krijoni lidhje me audiencën për një vazhdimësi.



## 4.2 PLATFORMAT ONLINE

Në ditët e sotme ka platforma të shumta mediash online në të cilat një reportazh mund të publikohet. Këtu janë disa prej platformave mediave sociale më të përdorura ku një reportazh mund të publikohet:

**Facebook** është një platformë e mediave sociale me një ndërfaqje shumë të mirë për publikimin e reportazheve pasi përdoruesit mund të komentojnë dhe të reagojnë ndaj tij.



**Instagram** përdoret gjerësisht për postimin e fotove dhe videove dhe është një alternativë e mirë duke konsideruar që është një platformë lehtësisht e përdorueshme nga të rinjtë.



**Youtube** gjithashtu duhet përmendur pasi dhe është një platformë për përmbajtje videosh.



## REFERENCAT

1. Center for Bridging Communities, website i projektit: “Forumi i Reporterëve të Rinj për Diversitetin”, [www.cbc.org.al/frd/](http://www.cbc.org.al/frd/)
2. Citizen Journalism video reportage, “How to make a video reportage with your smartphone”, <http://digitalstorylab.com/wp-content/uploads/2020/06/video-reportage-tutorial-4.pdf>
3. Oneil, D., “Photojournalism: a guide complete”, publikuar në datë 22.06.2023, <https://petapixel.com/what-is-photojournalism/>
4. Learn the Life, Training Toolkit: “For promotion of rural cultural heritage in rural communities through videos”, [https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/project-result-content/19ff62ec-1d8c-4f0c-8bf1-39fbb78960de/Training\\_Toolkit\\_EN.pdf](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/project-result-content/19ff62ec-1d8c-4f0c-8bf1-39fbb78960de/Training_Toolkit_EN.pdf)
5. Study Smarter: <https://www.studysmarter.co.uk/explanations/english-literature/literary-devices/reportage/>
6. Wilson, D., “How to make a video report”, publikuar në datë 20.04.2023, <https://democreator.wondershare.com/screen-recorder/how-to-make-a-video-report.html>